

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA TIRANË

FORMULARI NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpk;
Adresa: Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dyte, Tirane, & Autostrada Tirane Durres km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13 , Kashar, Tirana & Rruga Nacionale Kamez-Fsuhe-Kruje, kthesa e Valiasit Nr.1
Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Procedura e prokurimit: Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim ne Njësinë Administrative Krrabë.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58145-05-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,(i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Publikime të mëparshme: REF-53871-03-11-2020

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

Oferta ekonomike-Alternativa 1

1. Banesë individuale 1+1, vlera 2,753,352.1 (dy milion e shttaëqind e pesëdhjetë e tre mij e treqind e pesëdhjetë e dy pikë një) Lekë pa tvsh
2. Banesë individuale 1+2, vlera 3,156,385.9 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetëdhjetë e pesë pikë nëntë) Lekë pa tvsh;

3. Banesë individuale 1+3, vlera 3,911,423.3 (tre milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzetë e tre pikë tre) Lekë pa tvsh.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpk
NUIS K81716011V, NUIS L42215009L dhe NUIS K51712017A

Oferta ekonomike-Alternativa 1

1. Banesë individuale 1+1, vlera 2,090,000 (dy milion e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa tvsh;
2. Banesë individuale 1+2, vlera 2,390,000 (dy milion e treqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa tvsh;
3. Banesë individuale 1+3, vlera 3,090,000 (tre milion e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa tvsh.

Eshte skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

3. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertat e paraqitura nga operatorët e mësipërm ekonomikë janë identifikuar si oferta të pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrijnë pikët maksimale.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpkse oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 21/08/2020

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.